



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E AUDITIT TË BRËNDSHËM

Mbi Auditimin e Brëndshëm

Ushtruar në Drejtoria e Emergjencave Civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe

Shpëtimit, Bashkia Shkodër

Njësia e Auditimit Brëndshëm – Bashkia Shkodër bazuar në ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brëndshëm në sektorin publik”, VKM nr 212 datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e Njësive të Auditimit të Brëndshëm në sektorin publik”, zhvilloi një mision auditimi të plotë në Drejtorinë e Emergjencave Civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Bashkia Shkodër, për periudhën 01.07. 2015 deri 31.12. 2016 nga auditimi rezultoi:

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

Drejtoria e Emergjencave Civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit është institucion varesie i krijuar rishtas me urdher Nr.13 DT.19.01.2016. Gjate auditimit janë konstatuar mangesi në funksionimin e kontrollit të brendshëm, kryesisht në vendosjen e objektivave, në përshkrimin e proceseve të punës në kontrollin e aktiviteteve, në monitorimin dhe informimin si dhe në hartimin dhe ndjekjen e regjistrit të riskut. Ka pasur mangesi në mbledhjen e tarifave për shërbimet e kryera, nuk ka bashkëpunuar me drejtorite pranë Bashkisë Shkodër dhe institucionet e tjera për hartimin e regjistrit të ndertesave për të ushtruar kontroll. Për vitin 2016 nuk ka mbajtur akt-rakordime me drejtorinë e të ardhurave, për tarifën e arketuara.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1.Gjetje: Referuar ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, perkatesisht nenet 8-12, Drejtoria e Emergjencave Civile, mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, duhej të ishin përcaktuar qarte objektivat, përpilimi dhe miratimi i rregullores së brendshme, funksionimi i kontrollit të brendshëm, përpilimi i regjistrit të riskut, duhej të ishte ngritur grupi i menaxhimit strategjik.

Rekomandime Përshtatjen e rregullores së brendshme në përputhje me ligjin nr. 10296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, si dhe detajimin në mënyrë analitike të të gjithë aktiviteteve që kryen çdo punonjës, detajimin e sistemit kontrollit sipas aktiviteteve, miratimin e rregullores nga Kryetari i Bashkisë.

Përcaktimin e objektivave të institucionit, vlerësimin e mundësive së ndodhjes së ngjarjeve, si dhe përpilimin e regjistrit të rrishtit.

2.Gjetje Në referencë të pikës 3 të VKM Nr.285 DT.27.06.2002, “Për tarifën e shërbimeve që kryhen nga policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave juridike, dhe fizike, vendas dhe të huaj”, pas përfundimit të punimeve, policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, kontrollon, harton dhe jep aktin teknik kundrejt tarifës prej 5000 lek, si dhe për ripërteritjen vjetore të aktit teknik duhet të aplikojë tarifën prej 1000 lek, Drejtoria e Emergjencave Civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, nuk ka hartuar një regjister për të gjithë ndertesat që duhet të ushtrojnë kontroll teknik për çdo vit, në mënyrë që të bëhet e mundur arketimi i kësaj tarife.

Rekomandim Të bashkëpunojë me Drejtoritë pranë Bashkisë Shkoder dhe Institucionet e tjera për hartimin e regjistrit të ndertesave që duhet të ushtrojnë kontroll çdo vit, për ripërteritjen vjetore të akteve teknike.

3.Gjetje Referuar VKM Nr.784 DT.09.11.2016, Tarifa e ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve nga shërbimi i MZSH-së në objektet e siguruar nga zjarri nga shoqëritë e sigurimit është në vlerën 15 000 lekë për orë ndërhyrjeje, por Drejtoria e Emergjencave Civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit nuk ka listën e objekteve të siguruar.

4.Gjetje Referuar pikës 3,4 të nenit 7 të ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit” për çdo bashki ngrihet Stacioni i Shërbimit të MZSH-së, ku për çdo 1500-2000 banorë duhet të ketë 1 zjarrfikës profesionist, dhe çdo stacion duhet të ketë jo më pak se 14 zjarrfikës, personeli profesionist, nuk është plotësuar, sipas kërkesave të ligjit.

Rekomandime Në bashkëpunim me Bashkinë Shkoder të insistohet, pranë Drejtorisë Përgjithshme të Shërbimit Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, për vendosjen në dispozicion të listës për të gjitha subjektet të cilat janë të siguruar nga zjarri nga shoqëritë e sigurimit, si dhe të aplikojë tarifën në vlerën 15000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për orë ndërhyrjeje, në rast ndërhyrjeje për shuarjen e zjarreve për këto ndertesat.

Të bëhet kërkesë rritjen e numrit të zjarrfikësve profesionist.

Të ngrihet një komision për vlerësimin teknik të gjendjes së automjeteve dhe të përcaktohet gjendja teknike, si dhe të planifikohet fond mirëmbajtjeje të automjeteve në bazë të vlerësimit të gjendjes teknike nga komisioni.

5.Gjetje Referuar neneve 9, 23,24, të ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiare dhe kontrollin”, duhej te ishte kryer informimi i organeve eprore si dhe duhej te ishte ngritur sistemi i monitorimit, ndersa nëpunesi autorizues nuk ka informuar me shkrim te pakten ne fund te vitit ushtrimor lidhur me funksionimin e kontrollit te brendshem.

Rekomandim Ngritjen dhe funksionimin e sistemit te informimit dhe monitorimit, si dhe kryerjen e dokumentimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e efencës se institucionit.

6.Gjetje Ka mangesi ne mbajtjen e dosjeve te personelit, nuk eshte bërë vlersim i punës së punonjësve, nuk jane lidhur kontrata me punëmarresin, duke vepruar ne kundërshtim me nenin 12 te ligjit nr. 9761 date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe emerimet e personelit “punonjës operacional, inspektues, drejtues, me gradë”,sipas nenit 15/16 te ligjit 152/2015,ne momentin e kalimit te institucionit MZSH-se ne varesi te bashkise Shkoder, nuk janë te dokumentuara detyrat funksionale të punonjësve, sipas rregullores MZSH-se, Struktura organike 2017 nuk eshte e bere sipas ligjit nr 152/2015 dhe “Strukture se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri” te miratuar nga Sekretari Pergjithshem , Ministrise Puneve te Brendshme me shkresen nr 9019 date 29.12.2016,si dhe nuk janë përcaktuar dhe ndjekur fushat me rrisht të lartë.

Rekomandime Lidhjen e kontratës se punës për të gjithë personelin administrates,si dhe emerimet per personelin me grada, përcaktimin dhe dokumentimin e detyrave funksionale të punonjësve,sipas rregullores MZSh-se,përcaktimin dhe ndjekjen e fushave me rrisht të larte.

Plotesimin e dosjeve te punonjesve ,te listuar dhe nenshkruar nga zyra personelit, kryerjen e vlersimit te punes se punonjesve,kualifikimi i punonjesve me program dhe i dokumentuar.

Te percaktohet struktura organike sipas “Strukture se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri” te miratuar nga Sekretari Pergjithshem ,Ministrise Puneve te Brendshme me shkresen nr 9019 date 29.12.2016.

7.Gjetje Ne reference te pikes 263,te udhezimit Nr.02 DT.06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” duhej te ishte perpiluar dhe miratuar gjurma e auditit per zbatimin e buxhetit,por ka mangesi ne miratimin e perpilimin e gjurmes auditit per zbatimin e buxhetit.

Rekomandime Te kerkohet me shkrim, prane Drejtorise Planifikimit buxhetit ne Bashki per te marre asistencen e nevojshme per perpilimin e zbatimit e gjurmës auditit per buxhetin.

8.Gjetje Ne reference te VKM Nr. 285, date 27.6.2002,duhej te ishin aplikuar tarifa per te gjithë shërbimet e kryera nga Drejtoria e Emergjencave Civile,mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimet, ndërsa për një pjesë të shërbimeve nuk janë aplikuar tarifa.

Rekomandime Te behet listimi i shërbime dhe tarifave perkatëse per shërbimet shtese qe nuk jane te parashikuara ne VKM Nr.285,dhe te paraqiten per tu miratuar prane Keshillit Bashkiak.

Te mbahen akt-rakordime me drejtorine e te Ardhurave çdo muaj per arketimin e tarifave per shërbimet e kryera,sipas llojit.

9.Gjetje Ne reference te pikes 2 te V.K.M nr.594 DT.22.12.1997 “Per regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarresin e tij” duhej te ishte mbajtur rregjistrin i pagave ,por per te gjithë periudhen e audituar nuk eshte mbajtur rregjister pagash.

Rekomandim Te bëhet plotësimi i librit pagave sipas formatit miratuar.

10.Gjetje Referuar pikave 3,4,7 neni 2 , neni 40 te VKM nr 914 date 29.12.2014”Rregullat e prokurimit Publik”, Drejtuesi i institucionit duhet te sqaroje arsyen e kryerjes se shpenzimit, bashkëgjatur specifikimet e mallit ose te shërbimit,si dhe faturat duhet te nënshkruhen nga te gjithë anëtarët e komisionit.Nuk jane perpiluar raportet teknike te automjeteve.

Rekomandim Per te gjitha defektet e mjeteve te mbahet raport teknik,ne komisionin e vleresimit te ofertave te kete specialist fushe,faturat te firmosen nga gjithë anëtarët e komisionit.

11.Gjetje Nuk është përpiluar nje regjister i riskut lidhur me menaxhimin e aseteve. Nuk është zbaruar rregullorja për menaxhimin e aseteve duke vepruar në kundërshtim me pikat 5-9 te udhezimit nr. 30, nuk eshte ngritur komisioni i posacem per nxjerrjen e aktiveve nga perdorimi duke vepruar ne kundërshtim me piken 96 te udhezimit nr.30.

12.Gjetje Sipas pikave 38, 39, të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar për përdorimin e lëndës diegesë, duhej të ishte lëshuar autorizimi nga nëpunësi autorizues, si dhe të bëhej menjëherë dokumentimi nga përgjegjësi material,ndërsa nuk është lëshuar urdhër dorëzimi, nuk është bërë menjëhere dokumentim i veprimit dhe administrimi nuk është bërë nga përgjegjësi material. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi Ish Drejtori, Drejtori, Komandanti i stacionit dhe magazinieri.

Rekomandime Ti kërkohej me shkrim bashkise Shkoder, për venien në dispozicion te rregullores se aseteve te miratuar nga Kryetarja e Bashkise ,si dhe te kërkohej asistence per menaxhimin e aseteve.

Te ngrihet komisioni i nxjerrjes se aktiveve nga perdorimi i perbere jo me pak se 5 persona,per nxjerrjen jashte perdorimit te aktiveve te cilat jane vleresuar jasht funksioni nga komisioni i vleresimit te aktiveve.

Për të gjitha lëvizjet e asetëve të lëshohet urdhër dorëzimi,të bëhet menjehere dokumentimi me fletë dalje, si dhe të merren ne administrim kartat e përdorimit lëndës diegesë nga përgjegjësi material.